



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.2675/2 prot.

Datë 01.11.2023

FORMULAR PËR PUBLIKIM
LIDHUR ME ARSYET E SKUALIFIKIMIT NË RASTIN E ANKESAVE PËR
VENDIMIN E VLERËSIMIT/KLASIFIKIMIT PËRFUNDIMTAR

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur, e thjeshtuar” me Nr. REF-79555-09-11-2023 me objekt “Shërbim për rimbushjen dhe kolaudimin e pajisjeve kundër zjarrit”, me fond limit 7,497,514 lekë pa TVSH, zhvilluar me datë 22.09-2023 nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.

Ankimues: “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK me NIPT L62102007V dhe adresë “Gurten” sh.p.k., Rruga e Kavajës, nr.116 Tiranë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Përgjithshme e Objekteve Publike Tiranë.
Adresa: Rruga “5 Maji”, God.17, Tiranë.

Në datën 31.10.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi elektronik A/2023/3554 dhe me nr. 2675 prot., datë 01.11.2023 e operatorit ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Mbrojtja dhe Shpëtimi nga Zjarri” SHPK.

Bazuar në nenin 112 pika 4 gërma “b” të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, ku parashikohet se: “Në mënyrë që ankesa të bëhet e aksesueshme jo vetëm nga autoriteti ose enti kontraktor, por njëkohësisht edhe nga operatorët ekonomikë të interesuar, KPP-ja publikon: a) ankesën e plotë në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit; b) arsyet e skualifikimit në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar; c) pretendimet mbi kualifikimin/skualifikimin e ofertuesve të tjerë duke referuar vetëm kriteret për të cilat ngrihen pretendime” Komisioni i Prokurimit Publik do të publikojë arsyet e skualifikimit që operatori

ekonomik “Mbrotjtja dhe Shpëtimi nga Zjarri “ SHPK, kundërshton me anë të ankesës me numër ankimi elektronik elektronik A/2023/3554 dhe me nr. 2675 prot., datë 01.11.2023.

Konkretisht në ankesë ngrihen pretendime mbi arsyen e skualifikimit si më poshtë vijon:

- 1. Nuk plotëson pikën 2.3.8 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur skedat teknike për produktet Shkumë AFFF 916 (6%) dhe Dioksid karboni (CO₂).*
- 2. Nuk plotëson kërkesat e Kriterëve të Përgjithshme të Kualifikimit Pika 1 Paragrafi 2, pasi skeda teknike produktit pluhur ABC (40%) është paraqitur në gjuhë të huaj e papërkthyer.*
- 3. Nuk plotëson pikën 2.3.6 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin për kolaudimin e automjetit me targë AB904DB.*
- 4. Nuk plotëson pikën 2.1.4 të Kriterëve të Veçanta të Kualifikimit Shtojca 8 pasi nuk ka paraqitur dokumentacionin provues të akreditimit për entin certifikues që ka lëshuar certifikatat ISO 9001 dhe ISO 45001.*

Publikuar në rregjistrin e ankesave më datë 01.11.2023.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri